



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 08/2025 MBI KRITERET, STANDARDET
DHE PROCEDURAT E MBËSHTETJES PUBLIKE FINANCIARE PËR
SKENËN E PAVARUR KULTURORE¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 08/2025 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Mbështetjes Publike Financiare për Skenën e Pavarur Kulturore, i miratuar në Mbledhjen e 273-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 05/273, të datës 31.10.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr. Nr. 08/L - 245 për Artin dhe Kulturën, nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Miraton:

RREGULLORE (QRK) NR. 08/2025 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E MBËSHTETJES PUBLIKE FINANCIARE PËR SKENËN E PAVARUR KULTURORE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të veprimtarisë së skenës së pavarur kulturore (këtu e tutje: skena e pavarur kulturore) dhe kriteret për klasifikimin e ngjarjeve kulturore me rëndësi të veçantë, me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të individëve dhe organizatave të pavarura të shoqërisë civile (këtu e tutje: OJQ), përkritazi me programet dhe projektet kulturore që janë në interes publik të Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Këshilli i Skenës së Pavarur Kulturore (këtu e tutje: Këshilli) dhe Ministria përgjegjëse për kulturë (këtu e tutje: Ministria), gjatë ofrimit të mbështetjes financiare për veprimtarinë e skenës së pavarur kulturore, bazuar në aplikimet në thirrjet e hapura apo mundësitë e tjera të financimit që ofrohen nga ky Këshill.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen përshtatshmërisht edhe nga distribuesit jo-publikë të fondeve publike në fushën e kulturës, në rastet kur ato institucione bëjnë shpërndarjen e fondeve publike për skenën e pavarur kulturore, si pjesë e ndonjë marrëveshjeje të veçantë me Ministrinë.

3. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për fondet publike që ndahen nga institucionet e tjera publike për organizatat dhe subjektet e pavarura kulturore.

4. Dispozitat e rregullores nuk zbatohen për mbështetjen financiare publike që jepet në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, siç parashihet me legjislacionin në fuqi, në rastet e fatkeqësive natyrore apo emergjencave të tjera, kur për një gjë të tillë Qeveria e Republikës së Kosovës (këtu e tutje: Qeveria) dhe/apo Ministri përgjegjës për Kulturë (këtu e tutje: Ministri) vendosin shprehimisht me akt të veçantë. Në këto raste, Qeveria dhe/apo Ministri, në aktin përkatës, referojnë rregullat dhe procedurat që do të zbatohen gjatë periudhave kur janë në fuqi rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme, rastet e fatkeqësive natyrore apo emergjencat e tjera.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përkufizimet në vazhdim kanë këtë kuptim:

1.1. Burimet publike të financimit – nënkupton të gjitha fondet në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës të destinuara për mbështetje financiare për individë dhe OJQ për programe dhe projekte në fushën e artit dhe kulturës në kuadër të Ministrisë, përfshirë këtu edhe fondet nga burimet e jashtme të cilat menaxhohen nga Këshilli në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës;

1.2. Mbështetje financiare – nënkupton çdo formë të mbështetjes për skenën e pavarur kulturore, e cila shprehet në vlerë monetare, pa marrë parasysh emërtimin e saj, dhe, e cila ka për synim mbështetjen e OJQ-ve, programeve të OJQ-ve, projekteve apo aktiviteteve të veçanta të individëve apo OJQ-ve që janë pjesë e skenës së pavarur kulturore. Pagesat për shërbimet e blera nga subjektet e skenës së pavarur kulturore nuk përfshihen në kuadër të mbështetjes financiare;

1.3. Skena e pavarur kulturore – nënkupton individët dhe OJQ-të që veprimtarinë e tyre e kanë të lidhur me fushën e artit dhe kulturës, si dhe OJQ-të e tjera që zhvillojnë aktivitete, projekte apo programe kulturore për zbatimin e misionit të tyre, të cilët nuk janë të angazhuar apo nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore;

1.4. Ofruesi i mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore – nënkupton Ministrinë në rastet kur mbështet financiarisht skenën e pavarur kulturore, ose distribuesit jo-publikë të fondeve publike për skenën e pavarur kulturore, në rastet kur ato institucione bëjnë shpërndarjen e fondeve publike për skenën e pavarur kulturore si pjesë e ndonjë marrëveshjeje të veçantë me Ministrinë;

1.5. Aplikant – nënkupton një individ ose OJQ nga skena e pavarur kulturore që, në përgjigje të një thirrjeje publike ose mundësie tjetër të financimit, shpreh interesimin në formën përkatëse për të përfituar mbështetje financiare nga ofruesi i mbështetjes financiare, në përputhje me qëllimet dhe kriteret e thirrjes publike ose mundësisë tjetër të financimit;

1.6. Përfitues – nënkupton një individ ose OJQ që është shpallur fitues dhe/ose ka nënshkruar një kontratë me ofruesin e mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;

1.7. Aktivitet kulturor i interesit publik - nënkupton aktivitete të veçanta të njehershme që zhvillohen nga individë apo OJQ të skenës së pavarur kulturore dhe ofrojnë për publikun e gjerë, në baza të rregullta, aktivitete, projekte dhe programe kulturore, të cilat i shërbejnë mbrojtjes, kultivimit, krijimit, promovimit, shfrytëzimit dhe avancimit të vlerave kulturore, shprehjes artistike, përpjekjeve intelektuale kulturore, si dhe identitetit kulturor të grupeve të ndryshme sociale, e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror;

1.8. Projekt kulturor i interesit publik - nënkupton grupin e aktiviteteve që kanë një ndërlidhje logjike për t'i shërbyer një qëllimi të veçantë, të definuar në kohë që zhvillohen nga individë apo OJQ e skenës së pavarur kulturore dhe ofrojnë për publikun e gjerë, në baza të rregullta, aktivitete, projekte dhe programe kulturore, të cilat i shërbejnë mbrojtjes, kultivimit, krijimit, promovimit, shfrytëzimit dhe avancimit të vlerave kulturore, shprehjes artistike, përpjekjeve intelektuale kulturore, si dhe identitetit kulturor të grupeve të ndryshme sociale, e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror;

1.9. Program kulturor i interesit publik – nënkupton grupin e aktiviteteve dhe projekteve të njehershme ose të përsëritura të organizuara në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar në afat më të gjatë për t'i shërbyer një qëllimi më të përgjithshëm që zhvillohen nga individë apo OJQ të skenës së pavarur kulturore dhe ofrojnë për publikun e gjerë, në baza të rregullta, aktivitete, projekte dhe programe kulturore, të cilat i shërbejnë mbrojtjes, kultivimit, krijimit, promovimit, shfrytëzimit dhe avancimit të vlerave kulturore, shprehjes artistike, përpjekjeve intelektuale kulturore, si dhe identitetit kulturor të grupeve të ndryshme sociale, e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror;

1.10. Veprimtaria në fushën e artit dhe kulturës – nënkupton të shprehurit e kreativitetit dhe aftësive njerëzore përmes formave të ndryshme të vlerësuara për idenë, bukurinë dhe fuqinë emocionale, si dhe një mënyrë jetese, krijimtari dhe tërësi e tipareve shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie apo të një grupi shoqëror, të cilat manifestohen nëpërmjet veprimtarive që përfshijnë, por nuk kufizohen në aktivitete muzeore, art pamor, prodhime teatrore, prodhime muzikore, vallëzim, film, festivale kulturore, aktivitete të leximit, prodhime artizanale, trashëgimi kulturore, përvoja të kuzhinës dhe ushqimit, kultivim i pasurisë gjuhësore, festa tradicionale, folklor dhe tregimtari, karnevale dhe parada komunitare, shënim të ngjarjeve të rëndësishme historike, performanca në rrugë, si dhe aktivitete të tjera në drejtim të botimeve, hulumtimit, dokumentimit kulturor, promovimit, etj.;

1.11. Këshilli i skenës së pavarur kulturore – është organ këshillëdhënës që emërohet nga Ministri i Kulturës dhe kryen përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin përkatës për art dhe kulturë.

Neni 4

Parimet e përgjithshme të financimit publik për skenën e pavarur

1. Financimi publik për skenën e pavarur kulturore, bëhet duke u bazuar në parimet si vijon:

1.1. Konkurrueshmëria;

1.2. Trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe gjithëpërfshirja;

1.3. Transparenca në procedura dhe vendimmarrje gjatë gjithë ciklit të ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve;

1.4. Kriteret të përcaktuara më parë, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikantëve kundrejt objektivave dhe prioritetëve të mbështetjes financiare;

1.5. Parimi i efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike për skenën e pavarur kulturore, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;

1.6. Respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike për skenën e pavarur kulturore;

1.7. Përqendrimi i financimit përmes fondeve publike në aktivitete, projekte dhe programe që janë me prioritet për Republikën e Kosovës, në përputhje me politikat dhe legjislacionin në fuqi në fushën e kulturës, si dhe në interes të publikut;

1.8. Ruajtja e pavarësisë së përfituesve;

1.9. Parandalimi i çfarëdo konflikti të interesit;

1.10. Sigurimi i dyshkallshmërisë në trajtimin e ankesave të aplikantëve në procedurat e ofrimit të mbështetjes financiare përmes thirrjeve publike; dhe

1.11. Parandalimi i financimit të aktiviteteve kriminale, aktiviteteve të subjekteve politike, aktiviteteve fetare, aktiviteteve që synojnë përfitime personale ose biznesore, aktiviteteve për përfitime personale që nuk kanë interes publik, praktikave diskriminuese, aktiviteteve që nxisin urrejtje dhe dhunë, aktiviteteve që qartazi dëmtojnë ambientin, si dhe çfarëdo aktiviteti të paligjshëm dhe në kundërshtim me interesat e Republikës së Kosovës, politikat dhe legjislacionin në fuqi në fushën e kulturës, si dhe interesin publik.

KAPITULLI II

KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR FINANCIM PUBLIK NË FUSHËN E ARTIT DHE KULTURËS

Neni 5

Kriteret themelore për ofrimin e mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore

1. Kriteret themelore të domosdoshme për administrimin e skemës së mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore janë si vijon:

1.1. Hartimi dhe miratimi i dokumentit programor, i cili përcakton qartë qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të politikave të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore;

1.2. Buxheti i destinuar për mbështetje financiare për skenën e pavarur kulturore;

1.3. Kapacitete institucionale të mjaftueshme në dispozicion, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore, teknike dhe administrative për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve

1. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve për mbështetje financiare për skenën e pavarur kulturore, janë si vijon:

1.1. Të jenë të regjistruar si organizatë jo-qeveritare (këtu e tutje: OJQ) sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës; ose

1.2. Të jetë e themeluar e të veprojë si organizatë e diasporës dhe të jenë të regjistruar si OJQ ose formë ekuivalente të subjektit jo-për-përfitim në shtetin e huaj; ose

1.3. Të jetë person fizik shtetas ose rezident në Republikën e Kosovës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për shtetësi në Republikën e Kosovës.

2. Përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike për skenën e pavarur kulturore, aplikanti duhet të dëshmojë që:

2.1. Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, përveç rasteve të bashkëfinancimit;

2.2. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit dhe ofruesit të mbështetjes financiare, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe dispozitat e kësaj rregulloreje; dhe

2.3. Të mos ketë detyrime tatimore ndaj Republikës së Kosovës.

Neni 7

Format e ofrimit të mbështetjes financiare

1. Mbështetja publike financiare për skenën e pavarur kulturore ofrohet në format si vijon:

1.1. Mbështetja përmes thirrjeve të veçanta publike;

1.2. Mbështetja në raste emergjente;

1.3. Mbështetja për projekte/programme të rëndësishme të veçantë.

2. Mbështetja përmes thirrjeve të veçanta publike si në nënparagrafin 1 të paragrafit 1 të këtij neni mund të jetë:

2.1. Mbështetje për aktivitet;

- 2.2. Mbështetje për projekte afatshkurtra deri në një (1) vit;
 - 2.3. Mbështetje për projekte/programme afatmesme deri në tre (3) vjet;
 - 2.4. Mbështetje organizative për OJQ-të;
 - 2.5. Mbështetje joprogramore.
3. Këshilli, me aprovim të Ministrit, përveq modeleve të përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni mund të krijoj edhe modele të tjera të mbështetjes financiare që janë subjekt i thirrjeve të veçanta publike.
4. Këshilli për modelet si në paragrafin 3 të këtij neni duhet të përcaktoj elementet si në vijim:
- 4.1. Arsyeshmërinë e modelit të mbështetjes financiare;
 - 4.2. Qëllimin;
 - 4.3. Fushëveprimin;
 - 4.4. Periudhën e zbatimit;
 - 4.5. Shumën maksimale të mbështetjes;
 - 4.6. Afatet e thirrjes;
 - 4.7. Afatet e vlerësimit të aplikimeve;
 - 4.8. Subjektet e kualifikuara për aplikim;
 - 4.9. Kërkesat për aplikantët.
5. Këshilli nuk mund të krijoj model tjetër të mbështetjes financiare, në qoftëse qëllimi i tij mund të arrihet me modelet e përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni.
6. Për secilën thirrje publike, Këshilli përcakton modelin e mbështetjes financiare dhe specifikat përkatëse të modelit së mbështetjes, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Mbështetja për aktivitet

1. Mbështetja për aktivitet është mbështetja financiare për aktivitete të njehershme ose jo të rregullta, të cilat nuk janë pjesë e ndonjë projekti ose programi.
2. Mbështetja për aktivitet bazohet në kushtet/rrethanat si vijon:
 - 2.1. Mbështetja nuk tejkalon periudhën e zbatimit prej tre (3) muajsh;
 - 2.2. Mbështetja nuk tejkalon shumën prej dhjetë mijë (10,000) euro;

2.3. Thirrja për aplikim qëndron e hapur përgjatë gjithë periudhës kohore nga aprovimi i planit vjetor të mbështetjes financiare deri në shterimin e buxhetit përkatës, por jo më vonë se data tridhjetë (30) nëntor e vitit përkatës;

2.4. Vlerësimi i aplikimeve bëhet çdo muaj për të gjitha aplikimet që janë dorëzuar deri në ditën e fundit të muajit paraprak;

2.5. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë individët dhe OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat për aplikantët për këtë model të thirrjes përqendrohen por nuk kufizohen në:

3.1. Qëllimet dhe objektivat e aktivitetit/eve;

3.2. Grupet e synuara përmes aktivitetit/eve;

3.3. Rezultatet dhe ndikimin e pritur të aktivitetit/eve;

3.4. Kontributin e aktivitetit/eve në zhvillimin e qëndrueshëm;

3.5. Listën e aktiviteteve, nëse planifikohen të zbatohen më shumë se një i tillë;

3.6. Kërkesa buxhetore për zbatimin e aktivitetit/eve;

3.7. Kapacitetet e nevojshme për zbatimin e aktivitetit/eve.

Neni 9

Mbështetja për projekte afatshkurtra deri në një (1) vit

1. Mbështetja për projekte afatshkurtra deri në një (1) vit është mbështetja financiare për projekte që kanë një fushëveprim dhe qëllim të definuar qartë, të cilat mund të arrihen nëpërmjet aktiviteteve që zbatohen për një periudhë jo më të gjatë se një (1) vit.

2. Mbështetja për projekte afatshkurtra deri në 1 vit bazohet në kushtet/rrethanat si vijon:

2.1. Projekti nuk tejkalon periudhën e zbatimit prej dymbëdhjetë (12) muajsh;

2.2. Mbështetja financiare nuk tejkalon shumën prej dyzet mijë (40,000) euro;

2.3. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë individët dhe OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat për aplikantët për këtë model të thirrjes përqendrohen por nuk kufizohen në:

3.1. Qëllimet dhe objektivat e projektit;

3.2. Grupet e synuara përmes projektit;

- 3.3. Rezultatet dhe ndikimin e pritur të projektit;
- 3.4. Kontributin e projektit në zhvillimin e qëndrueshëm;
- 3.5. Listën e aktiviteteve të projektit;
- 3.6. Kërkesa buxhetore për zbatimin e projektit;
- 3.7. Kapacitetet e nevojshme për zbatimin e projektit.

Neni 10

Mbështetja për projekte/programë afatmesme deri në tre (3) vjet

1. Mbështetja për projekte/programë afatmesme deri në tre (3) vjet është mbështetja financiare për projekte/programë që kërkojnë një afat më të gjatë planifikimi dhe zbatimi, me qëllime dhe objektiva më të gjera, të cilat mund të arrihen nëpërmjet një grupi më kompleks të aktiviteteve që zbatohen për një periudhë deri në tre (3) vjet.
2. Mbështetja për projekte/programë afatmesme deri në tre (3) vjet, bazohet në kushtet/rrethanat si vijon:
 - 2.1. Mbështetja nuk tejkalon periudhën e zbatimit prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh;
 - 2.2. Mbështetja nuk tejkalon shumën prej njëqind mijë (100,000) euro në vit;
 - 2.3. Kontrata me përfituesin përfshin periudhën e plotë të mbështetjes, me kushtin e përmbushjes së suksesshme të obligimeve kontraktuale dhe disponueshmërisë së fondeve për vitet pasuese, pas vitit të parë;
 - 2.4. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e aplikueshme të pranueshmërisë, të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
3. Kërkesat për aplikantët për këtë model të thirrjes përqendrohen por nuk kufizohen në:
 - 3.1. Qëllimet dhe objektivat e projektit/programit;
 - 3.2. Grupet e synuara përmes projektit/programit;
 - 3.3. Rezultatet dhe ndikimin e pritur të projektit/programit;
 - 3.4. Rreziqet potenciale për realizimin e projektit/programit dhe masat për reduktimin e tyre;
 - 3.5. Kontributin e projektit/programit në zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor;
 - 3.6. Fushëveprimin dhe orientimin strategjik afatmesëm të OJQ-së;

- 3.7. Listën e aktiviteteve të projektit/programit;
- 3.8. Kornizën e mbikëqyrjes dhe raportimit të zbatimit të projektit/programit;
- 3.9. Kërkesa buxhetore për zbatimin e projektit/programit;
- 3.10. Kapacitetet e nevojshme për zbatim të projektit/programit, përfshirë ato njerëzore, teknike dhe financiare të OJQ-së;
- 3.11. Dëshminë mbi rregullsinë dhe disiplinën financiare të OJQ-së;
- 3.12. Partneritetet e OJQ-së.

Neni 11

Mbështetja organizative për OJQ-të

1. Mbështetja organizative për OJQ-të është model i mbështetjes financiare që synon avancimin dhe qëndrueshmërinë e OJQ-ve, duke përfshirë por mos u kufizuar në ofrimin e mbështetjes për shpenzime operationale të OJQ-së dhe/apo kornizës afatmesme programore.
2. Mbështetja organizative për OJQ-të bazohet në kushtet/rrethanat si vijon:
 - 2.1. Mbështetja nuk tejkalon periudhën e zbatimit prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh;
 - 2.2. Mbështetja nuk e tejkalon shumën prej njëqind mijë (100,000) euro në vit;
 - 2.3. Kontrata me përfituesin përfshin periudhën e plotë të mbështetjes, me kushtin e përmbushjes së suksesshme të obligimeve kontraktuale dhe disponueshmërisë së fondeve për vitet pasuese përveç vitit të parë;
 - 2.4. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje.
3. Kërkesat për aplikantët për këtë model të thirrjes përqendrohen por nuk kufizohen në:
 - 3.1. Qëllimet dhe objektivat e OJQ-së;
 - 3.2. Grupet e synuara përmes punës së OJQ-së;
 - 3.3. Rezultatet dhe ndikimin e pritur të projekteve dhe programeve të OJQ-së;
 - 3.4. Rreziqet potenciale për realizimin e kornizës afatmesme programore të OJQ-së dhe masat për reduktimin e tyre;
 - 3.5. Kontributin e punës së OJQ-së në zhvillimin e qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor;
 - 3.6. Strategjinë zhvillimore të OJQ-së, që përfshinë edhe kornizën afatmesme programore me listën e projekteve/programeve, listën e aktiviteteve dhe buxhetin përkatës;

- 3.7. Kornizën e mbikëqyrjes dhe raportimit të zbatimit të projekteve dhe programeve të OJQ-së;
- 3.8. Kërkesa buxhetore për mbështetje financiare;
- 3.9. Kapacitetet njerëzore, teknike dhe financiare të OJQ-së;
- 3.10. Dëshminë mbi rregullsinë dhe diciplinën financiare të OJQ-së;
- 3.11. Partneritetet e OJQ-së.

Neni 12

Mbështetja joprogramore

1. Mbështetja joprogramore është model i posaçshëm i mbështetjes financiare që nuk ka për qëllim mbështetjen direkte të krijimtarisë kulturore, por mbështetjen e komponenteve të veçanta të angazhimit të aplikantit duke përfshirë shpenzimet e lidhura me udhëtim jashtë vendit për pjesëmarrje në aktivitete kulturore që sigurojnë përfaqësim ndërkombëtar, shërim të lëndimeve të shkaktuara nga aktivitetet profesionale në fushën e kulturës, zhvillim dhe avancim profesional dhe arsimor në fushën e kulturës, dhe mbështetje të ngjashme.
2. Modeli i mbështetjes joprogramore është dizajnuar dhe zbatohet në çdo rast në mënyrë individuale, në varësi nga qëllimi përkatës, dhe përfshin përcaktimin e periudhës së zbatimit dhe kufijtë e mbështetjes financiare.
3. Thirrja për aplikim qëndron e hapur përgjatë gjithë periudhës kohore prej aprovimit të planit vjetor të mbështetjes financiare deri në shterimin e buxhetit përkatës, por jo më vonë se data tridhjetë (30) nëntor e vitit përkatës.
4. Vlerësimi i aplikimeve bëhet çdo muaj për të gjitha aplikimet që janë dorëzuar deri në ditën e fundit të muajit paraprak.
5. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë individët dhe OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje.
6. Kërkesat për aplikantët për këtë model të thirrjes, përqendrohen por nuk kufizohen në:
 - 6.1. Ofrimin e dëshmisë përkitazi me njërën nga rrethanat si në paragrafin 1 të këtij neni me shpjegimet përkatëse;
 - 6.2. Kërkesa buxhetore për zbatimin e aktivitetit/eve.

Neni 13

Mbështetja në rastet emergjente

1. Mbështetja në rastet emergjente është formë e mbështetjes financiare për aktivitete të cilat për shkak të rrethanave objektive, nuk mund të planifikohen apo janë rezultat i emergjencave që nuk varen nga aplikanti.
2. Mbështetja për raste emergjente mund të lejohet vetëm në rastet të cilat i plotësojnë kumulativisht kushtet si vijon:
 - 2.1. Kanë qenë të paparashikueshme, rrjedhimisht qartë ka qenë e pamundur që për to të planifikohet aplikimi për mbështetje i cili do të mund të administrohej nga thirrjet e veçanta publike;
 - 2.2. Qartë kërkon shqyrtim dhe eventualisht aprovim të mbështetjes në periudhë të tillë kohore që pamundëson shqyrtimin, eventualisht aprovimin në një nga thirrjet e veçanta publike; dhe
 - 2.3. Mbështetja nuk tejkalon periudhën e zbatimit prej tre (3) muajsh;
 - 2.4. Mbështetja nuk e tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro.
3. Kërkesat për aplikantët për këtë formë të thirrjes, përqendrohen por nuk kufizohen në:
 - 3.1. Qëllimet dhe objektivat e aktivitetit/ve;
 - 3.2. Grupet e synuara përmes aktivitetit/eve;
 - 3.3. Rezultatet dhe ndikimin e pritur të aktivitetit/eve;
 - 3.4. Listën e aktiviteteve nëse planifikohen të zbatohen më shumë se një (1) i tillë;
 - 3.5. Kërkesa buxhetore për zbatimin e aktivitetit/eve;
 - 3.6. Kapacitetet e nevojshme për zbatim të aktivitetit/eve.
4. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë individët dhe OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje.
5. Mbështetja në rastet emergjente, përjashtohet nga procedurat standarde të vlerësimit të thirrjeve të veçanta publike të mbështetjes të parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, nënparagrafin 1 të paragrafit 1, dhe paragrafin 2, ndërsa zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me kontratën me përfituesin, monitorimin dhe raportimin, mbylljen e kontratës dhe aspektet tjera të sigurimit të menaxhimit të duhur të mbështetjes publike financiare.

6. Vlerësimi i aplikimit, përkatësisht rekomandimi për mbështetje apo refuzim të aplikimit për mbështetje të kësaj forme bëhet vetëm nga Këshilli. Në rastet kur Këshilli miraton kërkesën, hartohet rekomandimi për Zyrтарin Kryesor Administrativ (këtu e tutje: ZKA) të Ministrisë në të cilin përveç tjerash përcaktohet shuma përkatëse për mbështetje financiare. ZKA është autoriteti që me akt administrativ, përfundimisht miraton rekomandimin e Këshillit.

Neni 14

Mbështetja për projekte/programe të rëndësisë së veçantë

1. Mbështetja për projekte/programe të rëndësisë së veçantë është formë e mbështetjes financiare për projektet/programet të cilat vlerësohen si të rëndësisë strategjike për fushën e artit dhe kulturës, përkatësisht që kanë ndikim domethënës në zhvillimin socio-kulturor dhe ekonomik të vendit, si dhe ndikojnë në promovimin dhe prezantimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

2. Mbështetja si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të administrohet vetëm në rastet kur për projektin/programin e caktuar, nuk mund të zbatohen kushtet dhe kriteret për format e mbështetjes të përcaktuara me nenin 8 deri në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

3. Subjektet e kualifikuara për mbështetje janë OJQ-të nga skena e pavarur kulturore, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje.

4. Mbështetja për projekte/programe të vecanta, përjashtohet nga procedurat standarde të vlerësimit të formave të rregullta të mbështetjes të parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, nënparagrafin 1 të paragrafit 1, dhe paragrafin 2, ndërsa zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me kontratën me përfituesin, monitorimin dhe raportimin, mbylljen e kontratës dhe aspektet tjera të sigurimit të menaxhimit të duhur të mbështetjes publike financiare.

5. Vlerësimi i aplikimit, përkatësisht rekomandimi për mbështetje apo refuzim të aplikimit për mbështetje të kësaj forme bëhet vetëm nga Këshilli. Në rastet kur Këshilli miraton kërkesën, hartohet rekomandimi për Ministrin në të cilin, përveç tjerash, përcaktohet shuma përkatëse për mbështetje financiare. Ministri është autoriteti që me akt administrativ, përfundimisht miraton rekomandimin e Këshillit.

KAPITULLI III

PLANIFIKIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR SKENËN E PAVARUR KULTURORE

Neni 15

Planifikimi buxhetor

1. Këshilli planifikon mbështetjen financiare për skenën e pavarur kulturore në përputhje me ndarjet dhe vlerësimet buxhetore, si dhe kushtet e përcaktuara me ligjin përkatës mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Këshilli në kuadër të planit afatmesëm të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore rekomandon, dhe në koordinim me Ministrinë, përcakton shumën e mbështetjes financiare për vitet përkatëse në përputhje me mundësitë buxhetore dhe obligimet kontraktuale si përcaktohen me legjislacionin në fuqi.

3. Këshilli në kuadër të planit vjetor të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore rekomandon, dhe në koordinim me Ministrinë, përcakton shumën e mbështetjes financiare për çdo thirrje të planifikuar për vitin përkatës, dhe vitet pasuese në rastin e thirrjeve për mbështetje tre (3) vjeçare, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe obligimet kontraktuale si përcaktohen me legjislacionin në fuqi.

4. Planifikimi buxhetor i mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore bëhet në përputhje me afatet, kërkesat dhe dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm për përgatitjen e buxhetit në Republikën e Kosovës.

Neni 16

Planifikimi programor

1. Këshilli planifikon pjesën programore të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore në interes të publikut dhe në përputhje me dokumentet strategjike të Republikës së Kosovës, politikat dhe legjislacionin në fuqi në fushën e artit dhe kulturës.

2. Planifikimi programor i mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore bëhet nëpërmjet:

2.1. planit afatmesëm, i cili përfshin së paku një periudhë tre (3) vjeçare;

2.2. planit vjetor.

Neni 17

Plani afatmesëm i mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore

1. Këshilli harton dhe i rekomandon Ministrit miratimin e planit afatmesëm të mbështetjes financiare për skenën e pavarur (këtu e tutje: plani afatmesëm).

2. Gjatë hartimit të planit afatmesëm, Këshilli zhvillon konsultime publike me skenën e pavarur kulturore dhe akterë të tjerë, me çrast ndërmerr por nuk kufizohet në veprimet si vijon:

2.1. Zhvillon së paku një takim të hapur publik, gjatë të cilit informon pjesëmarrësit për qëllimet e përgjithshme programore të mbështetjes financiare dhe mbledh informata për kërkesat e skenës së pavarur kulturore me qëllim të identifikimit të nevojave dhe prioriteteve të tyre rreth mbështetjes financiare në periudhën përkatëse kohore;

2.2. Publikon projekt-planin afatmesëm për konsultim publik për periudhën pesëmbëdhjetë (15) ditë pune dhe të ofrojë mundësi praktike për ofrimin e komenteve nga pjesëtarët e shoqërisë civile;

2.3. Publikon raportin e konsultimit publik të projekt-planit afatmesëm i cili përfshin procesin e konsultimit publik, dhe në formë tabelare paraqet komentet, nëse të njëjtat janë pranuar plotësisht, janë pranuar pjesërisht ose janë refuzuar, së bashku me arsyet përkatëse.

3. Plani afatmesëm përfshin por nuk kufizohet në pikat si vijon:

3.1. Informata për Këshillin dhe planin e përgjithshëm të punës së Këshillit;

3.2. Qëllimin dhe fushëveprimin e planit afatmesëm;

3.3. Procesin e hartimit të planit afatmesëm;

3.4. Përmbledhje të planit paraprak afatmesëm, arritjeve kryesore dhe mësimave të mësuara;

3.5. Pasqyrën e gjendjes ekzistuese të skenës së pavarur kulturore;

3.6. Vizioni, qëllimet dhe objektivat e mbështetjes financiare të skenës së pavarur kulturore;

3.7. Planifikimi buxhetor sipas viteve përkatëse të planit afatmesëm;

3.8. Korniza e mbikëqyrjes dhe treguesit e vlerësimit.

4. Këshilli inicon procesin e rishikimit dhe hartimit të planit afatmesëm të mbështetjes financiare në rrethanat si vijon:

4.1. Nëse politikat dhe strategjitë kombëtare në fushën e artit dhe kulturës kanë pësuar ndryshime domethënëse, dhe plani afatmesëm vlerësohet të mos jetë në përputhje me politikat dhe strategjitë e reja;

4.2. Nëse raporti vjetor i vlerësimit të zbatimit të planit rezulton në shkallë të arritjes nën vlerën shtatëdhjetë për qind (70%) të caceve të përcaktuara me këtë plan, për dy (2) vite radhazi;

4.3. Një (1) vit para skadimit të periudhës së planit afatmesëm të mbështetjes financiare;

4.4. Në rast se kohëzgjatja e planit afatmesëm për mbështetje financiare tejkalon periudhën tre (3) vjeçare. Në këtë rast, në vitin e tretë (3) të zbatimit të planit, Këshilli konfirmon vlefshmërinë e tij përmes konsultimit publik sikurse është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Ministri miraton planin afatmesëm të mbështetjes financiare.

6. Këshilli dhe Ministria publikojnë në ueb faqet e veta planin afatmesëm të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore më së largu pesë (5) ditë pas miratimit të tij.

Neni 18

Plani vjetor i mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore

1. Këshilli harton dhe i rekomandon Ministrit miratimin e planit vjetor të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore (këtu e tutje: plani vjetor) më së largu tridhjetë (30) ditë pas miratimit të ligjit përkatës mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Plani vjetor përfshin por nuk kufizohet në pikat si vijon:
 - 2.1. Informata të përgjithshme dhe plani i punës së Këshillit;
 - 2.2. Qëllimet, caqet dhe treguesit e vlerësimit të planit vjetor për fushat e mbështetjes, si dhe ndërlidhjen me interesin publik, strategjitë, politikat e tjera publike për art dhe kulturë, si dhe planin afatmesëm të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore;
 - 2.3. Shumën e planifikuar të mbështetjes financiare për vitin fiskal dhe dy (2) vitet pasuese në rast të mbështetjes shumëvjeçare, të ndarë në fusha kryesore;
 - 2.4. Modelet e mbështetjes financiare, shumat e përafërta për secilën model, si dhe kalendarin e përafërt të thirrjeve për aplikim;
 - 2.5. Kategoritë kryesore të organizatave dhe subjekteve të pavarura që synohen me mbështetjen financiare;
 - 2.6. Numrin e thirrjeve publike dhe ndarjet buxhetore për secilën thirrje publike;
 - 2.7. Kriteret për mbështetje në raste emergjente dhe për projekte/programe të rëndësishë së veçantë të përcaktuara me nenin 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje;
 - 2.8. Plani i rekrutimit të ekspertëve të vlerësimit përmbajtësor.
3. Ministri miraton planin vjetor të mbështetjes financiare në fushën e kulturës më së largu dyzet e pesë (45) ditë pas miratimit të ligjit përkatës mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Këshilli dhe Ministria publikojnë në ueb faqet e veta planin vjetor të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore më së largu dyzet e pesë (45) ditë pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV

THIRRJA PUBLIKE DHE MUNDËSITË E TJERA TË FINANCIMIT

Neni 19

Shpallja publike e thirrjes për mbështetje financiare

1. Pas miratimit të planit afatmesëm dhe vjetor të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore dhe në zbatim të tyre, hartohet thirrja publike, e cila miratohet nga ZKA.

2. Thirrja publike shpallet në ueb faqen e Ministrisë dhe Këshillit.
3. Thirrja publike duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, përveç në rastet kur është përcaktuar ndryshe nga dispozitat e kësaj rregulloreje.
4. Këshilli, me aprovim të shumicës së anëtarëve mund të vendosë shtyerjen e cilitdo prej afateve të thirrjeve publike së paku dy (2) ditë pune para afatit të mbylljes.
5. Këshilli organizon së paku një (1) sesion të hapur informues për thirrjen apo thirrjet publike jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune para mbylljes, me qëllim të ofrimit të informacioneve dhe sqarimeve të detajuara për kërkesat dhe procesin e thirrjes/eve publike në një mënyrë lehtë të kuptueshme për pjesëmarrësit.
6. Sesioni informues transmetohet drejtpërdrejtë në faqet e rrjeteve sociale të Këshillit dhe Ministrisë. Në rast të pamundësisë teknike për transmetim të drejtpërdrejtë, sesioni informues incizohet dhe publikohet i plotë në faqet e rrjeteve sociale të Këshillit dhe Ministrisë, jo më vonë se dy (2) ditë pune pas mbajtjes së sesionit informues.
7. Gjatë kohës kur thirrja është e hapur, palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime dhe informacione shtesë përkitazi me thirrjen, por jo më vonë se dy (2) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.
8. Përgjigjet e të gjitha pyetjeve të palëve të interesuara, qoftë gjatë sesioneve informuese apo pyetjeve me shkrim, bëhen publike.
9. Të gjitha materialet që prodhohen nga aktivitetet e përcaktuara në paragrafët 5,6,7 dhe 8 të këtij neni ruhen në dosjen e thirrjes.

Neni 20

Përmbajtja e thirrjes publike

1. Thirrja publike për aplikim paraqet një artikulum të veçantë nëpërmjet të cilit Këshilli publikon informatat që ndihmojnë aplikantët potencialë të kuptojnë drejt qëllimet dhe kërkesat për mbështetjen përkatëse financiare.
2. Thirrja publike duhet të përmbajë informacionin në vijim:
 - 2.1. Emrin e thirrjes publike;
 - 2.2. Një përshkrim të fushëveprimit të thirrjes publike, dokumenteve relevante strategjike dhe të politikave, problemit dhe/ose nevojave të cilat synohet të trajtohen përmes mbështetjes financiare;
 - 2.3. Informatën se cilat prej kategorive të aplikantëve, të përcaktuara në nenin 6, paragrafin 1, kualifikohen për thirrjen përkatëse;
 - 2.4. Qëllimet e përgjithshme të thirrjes publike dhe prioritetet programore për ndarjen e mbështetjes financiare;

- 2.5. Kushtet dhe kriteret për aplikim dhe vlerësim, apo informacione dhe tregues specifik për aktivitetet, projektet ose programet që synohen të mbështeten financiarisht;
- 2.6. Informatën nëse lejohen partnerët dhe kërkesat përkatëse për partnerë;
- 2.7. Dëshmitë e detyrueshme dhe jo të detyrueshme për aplikim, si dhe fazën e paraqitjes së dëshmimeve të caktuara;
- 2.8. Shpenzimet e pranueshme që mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike përkatëse;
- 2.9. Shpenzimet e papranueshme që nuk mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike përkatëse;
- 2.10. Aktivitetet e lejueshme që mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike përkatëse;
- 2.11. Aktivitetet e palejueshme që nuk mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike përkatëse;
- 2.12. Kohëzgjatjen minimale dhe maksimale për zbatimin e mbështetjes financiare;
- 2.13. Kufijtë buxhetorë minimal dhe maksimal të mbështetjes financiare (sipas vendimi të Këshillit, kufijtë buxhetor minimal mund të mbesin të papërcaktuara);
- 2.14. Shumën e përgjithshme të mjeteve në dispozicion për thirrjen publike përkatëse;
- 2.15. Kuotat eventuale të aplikueshme për kategori të veçanta të komunitetit, kur aplikohet;
- 2.16. Datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes publike, përfshirë orën e saktë të mbylljes së thirrjes;
- 2.17. Të dhëna të sakta dhe të qarta për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve;
- 2.18. Orarin e saktë të sesioneve informuese për thirrjen përkatëse;
- 2.19. Kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të pyetjeve gjatë kohës që thirrja publike është e hapur, si dhe mënyrën e publikimit të përgjigjeve;
- 2.20. Procesin e vlerësimit, përfshirë tabelën me kriteret e vlerësimit dhe peshën e tyre, në rastet kur aplikohet. Për mbështetjen financiare për projekte afat-mesme dhe mbështetjes organizative, përcaktohet nëse gjatë vlerësimit të aplikimeve do të ketë intervista publike sipas kushteve të përcaktuara me këtë rregullore;
- 2.21. Kushtet dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave;
- 2.22. Informacione të përgjithshme mbi përmbajtjen e kontratave me përfitues;
- 2.23. Informacione të përgjithshme mbi raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës; dhe
- 2.24. Të dhëna për kalendarin e përafërt të kontraktimit.

3. Thirrja publike mund të plotësohet me aprovim të shumicës së anëtarëve të Këshillit dhe vetëm nëse plotësimet nuk e ndryshojnë në thelb përmbajtjen e thirrjes, e në veçanti qëllimin dhe kriteret përkatëse. Në të kundërt, thirrja publike anulohet dhe shpallet nga fillimi.

4. Plotësimet nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas shpalljes së thirrjes publike, dhe të gjitha plotësimet publikohen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin vend, si thirrja publike bazë. Në rast të plotësimeve të tilla, Këshilli shpjegon arsyet dhe i bën publike në të njëjtën mënyrë sikurse thirrjen publike.

5. Plotësimet nga paragrafi 2 i këtij neni nuk mund të jenë në dëm të aplikantëve të cilët kanë aplikuar deri në datën e publikimit të korrigjimeve të tilla. Nëse ka plotësime të tilla, aplikantëve duhet t'u jepet mundësia të korrigjojnë aplikacionin e tyre apo të sigurojnë dëshmi shtesë.

Neni 21

Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për aplikim

1. Çdo thirrje publike përcakton kushtet dhe kriteret e vlerësimit për aktivitetet, projektet ose programet që synohen të mbështeten financiarisht, që mund të lidhen me kërkesa administrative, teknike dhe financiare, apo me kërkesa specifike përmbajtësore që dalin nga dokumentet strategjike, politikat, planet dhe programet e tjera zhillimore të fushës ose nënfushës përkatëse.

2. Kriteret mund të jenë kritere të pranueshmërisë apo kritere me peshim duke u bazuar, por mos u kufizuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe dispozitave përkatëse për modelet e mbështetjes financiare, përkatësisht neni 8 deri në nenin 12, varësisht nga modeli i aplikuar i mbështetjes financiare të thirrjes publike.

3. Kriteret mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

3.1. Aplikimet të bëhen brenda afatit të përcaktuar me thirrjen publike dhe sipas formularëve përkatës, duke ofruar dëshmitë e detyrueshme për aplikim në përputhje me kërkesat e thirrjes publike;

3.2. Propozimet e dorëzuara të jenë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e thirrjes publike përkatëse;

3.3. Propozimet e dorëzuara të jenë relevante në raport me problemet dhe/ose nevojat të cilat synohet të trajtohen përmes mbështetjes financiare me thirrjen publike përkatëse, përfshirë dokumentet strategjike apo të politikave në fushën përkatëse;

3.4. Strategjia e zbatimit në kuadër të propozimit të jetë koherente dhe cilësore, duke përfshirë qartësinë e qëllimeve dhe objektivave; mënyrën e identifikimit, përfshirjes dhe punës me grupet e targetuara; ndërlidhjen logjike të raporteve kauzale ndërmjet aktiviteteve, rezultateve dhe ndikimit të pritur; përshtatshmërinë e aktiviteteve të propozuara në raport me qëllimin dhe grupet e targetuara; sa janë reale për t'u zbatuar në praktikë aktivitetet e propozuara; rreziqet dhe mënyrat e vlerësimit dhe trajtimit të rreziqeve; bashkëpunimet dhe partneritetet me hisedarët tjerë; kornizën e mbikëqyrjes dhe raportimit; planet e qëndrueshmërisë; ndjeshmërinë ndaj rrethanave shoqërore dhe kulturore, gjithëpërfshirjen, si dhe kërkesa apo kritere tjera të përcaktuara/lejuara me këtë rregullore;

- 3.5. Buxheti i propozuar për mbështetje nga Ministria të jetë në kuadër të kufizimeve të lejuara me thirrjen përkatëse publike dhe t'i kontribuojë arritjes së qëllimeve të propozimit duke qenë i qartë, real, në përputhje me çmimet e tregut, dhe i përshtatshëm për zbatimin e aktiviteteve të propozuara;
- 3.6. Të jetë individ ose OJQ që dëshmon përvojë të caktuar, qoftë për nga kohëzgjatja apo natyra e punës përmes dëshmive përkatëse;
- 3.7. Të jetë individ ose OJQ që dëshmon kapacitete të caktuara njerëzore, teknike, financiare apo profesionale, përmes dëshmive përkatëse, që janë të mjaftueshme për të garantuar zbatim të duhur të propozimit, varësisht nga kompleksiteti dhe kërkesat e propozimit;
- 3.8. Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licensë nga autoritetet publike;
- 3.9. T'i takojë, ta përfaqësojë ose t'i shërbejë një kategori të caktuar të popullsisë, një rajoni të caktuar gjeografik ose një fushë të caktuar profesionale, duke prezantuar dëshmi për përkatësinë në kategorinë, rajonin ose fushën e caktuar.
4. Tabela me kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret me peshim, si dhe kushtet përkatëse të vlerësimit janë pjesë e thirrjes publike.
5. Në çdo thirrje publike përcaktohet qartë pesha e secilit kriter me peshim. Numri maksimal i pikëve të kriterëve në mënyrë kumulative është 100 pikë, ndërsa asnjëri nga kriteret me peshim nuk mund të ketë më shumë se 40 pikë.
6. Në çdo thirrje publike përcaktohen qartë se cilat prej kriterëve të pranueshmërisë janë obligative për t'u plotësuar qysh në fazën e aplikimit, cilat duhet të plotësohen gjatë fazës së vlerësimit, e cilat para nënshkrimit të kontratës.
7. Në çdo thirrje publike përcaktohen qartë se çfarë lloj dëshmish duhet të dorëzohen, dhe në cilën fazë, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve përkatëse. Në përcaktimin e dëshmive përkatëse, Këshilli udhëhiqet nga parimi i proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, e që nënkupton kërkesat minimale të cilat dëshmojnë plotësimin e kriterit përkatës.
8. Aplikanti duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret përkatëse duke vënë në dispozicion dëshmitë sipas dispozitave të këtij neni dhe/apo kriterëve të thirrjes publike.
9. Aplikanti nuk mund të përfitojë mbështetje financiare nëse:
- 9.1. Vlerësimi i buxhetit nuk ka rezultuar me të paktën pesëdhjetë e një për qind (51%) të pikëve për kategorinë e buxhetit;
- 9.2. Nëse mbi tridhjetë për qind (30%) e vlerës së shpenzimeve të propozuara në kuadër të kërkesës buxhetore të aplikimit vlerësohen si shpenzime të palejuara;
- 9.3. Nëse kërkesa buxhetore e aplikimit vlerësohet si e papërgjegjshme.

10. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret përkatëse para përfundimit të fazës së përcaktuar në thirrjen publike, aplikacioni konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Neni 22

Mënyra e aplikimit

1. Aplikimi për mbështetje financiare nga aplikanti bëhet nëpërmjet sistemit elektronik, prej momentit të hapjes së thirrjes deri në afatin e fundit për aplikim të përcaktuar në thirrjen e hapur apo formave të tjera të mbështetjes financiare.
2. Sistemi elektronik për mbështetje financiare (këtu e tutje: sistemi elektronik) siguron format elektronike të aplikimit, adekuate me format përkatëse të mbështetjes financiare, në udhëzimet e përcaktuara në thirrje publike.
3. Format standarde të aplikimit përmes sistemit elektronik, dizajnohen në atë mënyrë për të ofruar informacion të mjaftueshëm për secilin kriter përmbajtësor të vlerësimit.
4. Sistemi elektronik siguron mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi, konfidencialitetin dhe pacenueshmërinë e aplikacioneve që pranohen, si dhe qasjen në aplikimet e dorëzuara, vetëm nga personat e autorizuar dhe atë vetëm pas përfundimit të afatit për aplikim.
5. Sistemi elektronik siguron që në momentin e dorëzimit të aplikimit, kopja elektronike e aplikimit e dorëzuar në sistem i vihet në dispozicion edhe aplikantit.
6. Një apo më shumë dëshmi të deponuara në sistemin elektronik gjatë aplikimit në një thirrje publike, mund të përdoren në aplikimet e ardhshme, përkatësisht thirrjet e ardhshme publike, kurdo që të njëjtat kanë vlefshmëri dhe janë të aplikueshme.
7. Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), me akt të veçantë, miraton procedurën standarde operative për funksionimin, qasjet dhe privilegjet në administrimin e sistemit elektronik.

Neni 23

Mbyllja e afatit për aplikim

1. Në orën e saktë të përcaktuar në thirrjen e hapur, sistemi elektronik mbyllet automatikisht dhe nuk pranon aplikime të reja.
2. Sistemi elektronik, pas mbylljes, gjeneron automatikisht listën e aplikantëve, me të dhënat minimale si vijon:
 - 2.1. Emri i aplikantit;
 - 2.2. Titulli i propozimit;
 - 2.3. Titulli i thirrjes publike në të cilën ka aplikuar;

2.4. Periudha e propozuar e zbatimit;

2.5. Buxheti i propozuar.

3. Sistemi elektronik gjeneron njoftimin për mbylljen e thirrjes të ZKA, Këshilli dhe zyrtarët e autorizuar për administrimin e thirrjes.

Neni 24 **Vlerësimi administrativ**

1. ZKA, me akt administrativ, autorizon zyrtarin/en apo zyrtarët përgjegjës të MKRS-së për vlerësimin administrativ, së paku dy (2) ditë pune para datës së mbylljes së thirrjes publike. Në rastet kur thirrjet publike qëndrojnë të hapura gjatë gjithë periudhës kohore prej aprovimit të planit vjetor, zyrtarët përgjegjës autorizohen për vlerësimin administrativ të aplikimeve të thirrjes publike deri në fund të vitit përkatës fiskal.

2. Brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e mbylljes së thirrjes publike, zyrtari/ët i/e autorizuar i/të Ministrisë, bën/jnë vlerësimin administrativ i cili konsiston në verifikimin e disponueshmërisë së dëshmive të përcaktuara me thirrje publike dhe/apo dorëzimin e tyre në formën e kërkuar.

3. Raporti, përkatësisht rezultati dhe arsyetimi përkatës nga vlerësimi administrativ si në paragrafin 1 të këtij neni dërgohet nëpërmjet sistemit elektronik të secili aplikant.

4. Brenda dy (2) ditëve të punës nga pranimi i raportit, aplikanti i cili nuk ka kaluar vlerësimin administrativ, ka të drejtë që në sistem të ngarkojë një parashtrim të arsyetuar ankimor dhe të plotësojë dëshmitë e munguara apo të dorëzuara në formë të parregullt, me kushtin që të njëjtat janë hartuar/lëshuar para datës së aplikimit.

5. Pas kalimit të afatit për plotësimin e dëshmive të munguara apo të dorëzuara në formë të parregullt, brenda tri (3) ditëve të punës zyrtarët e autorizuar shqyrtojnë dëshmitë si në paragrafin 3 të këtij neni, dhe përfundojnë vlerësimin administrativ.

6. Pas përfundimit të vlerësimit administrativ, secili aplikant pranon njoftimin për rezultatin përfundimtar.

7. Lista e të gjitha aplikimeve që e kanë kaluar me sukses vlerësimin administrativ në ditën e përfundimit të procesit aprovohet nga ZKA dhe ndahet me Këshillin dhe zyrtarët e autorizuar për vlerësimin përmbajtësor, së bashku me gjithë dosjen e dokumentacionit të dorëzuar.

Neni 25 **Vlerësimi përmbajtësor i aplikimeve**

1. Vlerësimi përmbajtësor, zhvillohet nga komisioni i vlerësimit përmbajtësor, përkatësisht ekspertët e autorizuar nga Këshilli.

2. Vlerësimi përmbajtësor bazohet në kriteret dhe udhëzimet e tjera të përcaktuara në thirrjen publike si dhe formularin përkatës të vlerësimit përmbajtësor, dhe fillon menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit administrativ, përkatësisht pas ndarjes së listës së aplikimeve që kanë kaluar me sukses vlerësimin administrativ si në paragrafin 7 të nenit 24.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas pranimit të njoftimit për përfundimin e vlerësimit administrativ, Këshilli përcakton afatin për përfundimin e vlerësimit përmbajtësor, bazuar në numrin e aplikimeve për vlerësim dhe numrin mesatar të aplikimeve që mund të vlerësohen për një ditë pune për modelin përkatës.
4. Vlerësimi përmbajtësor përbën rezultatin mesatar të vlerësimeve individuale nga zyrtarë të autorizuar për vlerësimin përmbajtësor, në përputhje me format e paracaktuara standarde për këtë qëllim.
5. Për mbështetjen për projekte afat-mesme dhe mbështetjes organizative, brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga vlerësimi preliminar përmbajtësor mund të mbahen intervistat publike me të gjithë aplikantët të cilët kanë më shumë se gjashtëdhjetë (60) pikë.
6. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga përfundimi i intervistave publike për rastet si në paragrafin 5 të këtij neni, duhet të përfundojë vlerësimi përmbajtësor.
7. Ekspertët e autorizuar për vlerësim përmbajtësor, brenda pesë (5) ditëve pas përfundimit të vlerësimit preliminar mund të zhvillojnë takime konsultative për qëllim të vlerësimit përkatës përmbajtësor, vetëm në kushtet/rrethanat si vijon:
 - 7.1. Kur identifikohen diskrepanca të theksuara në mes të vlerësimeve individuale në kuptim të pikëve të vlerësimit për kritere të caktuara, përkatësisht nëse diskrepaca e tillë është mbi tridhjetë përqind (30%);
 - 7.2. Kur identifikohen mospërputhje në mes të vlerësimeve individuale nëse një shpenzim në kuadër të kërkesës buxhetore të aplikimit është i lejuar apo i palejuar. Në këtë rast zyrtarët përgjegjës në mënyrë konsensuale duhet të përcaktohen për vlerësimin përfundimtar;
 - 7.3. Kur identifikohen mospërputhje në mes të vlerësimeve individuale nëse kërkesa buxhetore është e përgjegjshme apo e papërgjegjshme. Në këtë rast zyrtarët përgjegjës në mënyrë konsensuale duhet të përcaktohen për vlerësimin përfundimtar;
 - 7.4. Kur identifikohen mospërputhje në mes të vlerësimeve individuale nëse një aktivitet në kuadër të planit të aktiviteteve të aplikimit është i lejuar apo i palejuar. Në këtë rast zyrtarët përgjegjës në mënyrë konsensuale duhet të përcaktohen për vlerësimin përfundimtar;
 - 7.5. Kur identifikohen mospërputhje në mes të vlerësimeve individuale të kriterëve të përshtatshmërisë. Në këtë rast zyrtarët përgjegjës në mënyrë konsensuale duhet të përcaktohen për vlerësimin përfundimtar.
8. Ekspertët e autorizuar për vlerësim përmbajtësor, pas takimit konsultativ si në paragrafin 7 të këtij neni mund të rishikojnë vlerësimin individual jo më vonë se dy (2) ditë pune pas mbajtjes së takimit.

9. Për aplikimet që vlerësohen nga dy (2) vlerësues, në rast që vlerësimet individuale të dy (2) vlerësuesëve kanë diskrepanca të theksuara në mes njëra-tjetrës dhe diskrepanca vazhdon të mbetet e theksuar edhe pas takimit konsultativ sipas paragrafit 7 të këtij neni dhe rishikimeve të vlerësimeve individuale sipas paragrafit 8 të këtij neni, duhet të autorizohet vlerësuesi i tretë për vlerësim të aplikimit përkatës, pikët e të cilit përfshihen në rezultatin mesatar të vlerësimeve individuale.

10. Vlerësimi përmbajtësor individual është nga zero (0) deri njëqind (100) pikë.

11. Aplikantët të cilët në vlerësimin përmbajtësor marrin më pak se shtatëdhjetë (70) pikë nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare në asnjë rast.

12. Pavarësisht rezultatit përfundimtar të vlerësimit, asnjë aplikant nuk mund të përfitojë mbështetje financiare nëse:

12.1. Vlerësimi i buxhetit nuk ka rezultuar me të paktën pesëdhjetë e një për qind (51%) të pikëve për kategorinë e buxhetit;

12.2. Nëse mbi tridhjetë për qind (30%) e vlerës së shpenzimeve të propozuara në kuadër të kërkesës buxhetore të aplikimit vlerësohen si shpenzime të palejuara;

12.3. Nëse kërkesa buxhetore e aplikimit vlerësohet si e papërgjegjshme.

13. Në rast se numri i aplikantëve që marrin më shumë se shtatëdhjetë (70) pikë është më i madh se sa numri i paraparë i përfituesve për atë thirrje, aplikantët me më shumë pikë do të jenë përfitues. Në rast të aplikimit të kuotave për kategori të caktuara sipas kushteve dhe kritereve të thirrjes përkatëse publike, lista e rekomanduar për financim përfshin edhe kërkesat përkatëse për kuota.

14. Kriteret për vlerësimin e aplikacionit me peshën përkatëse duhet të bëhen publike si pjesë e thirrjes publike.

15. Raporti i vlerësimit përmbajtësor në ditën e përfundimit të procesit, ndahet me Këshillin. Ky raport ofron listën e rekomanduar për financim me të dhënat e përgjithshme si në paragrafin 2 të nenit 23, si dhe rezultatin e vlerësimit përmbajtësor së bashku me pikët e përgjithshme, komentet e anonimizuara të ekspertëve të autorizuar për vlerësim përmbajtësor dhe buxhetin e lejuar sipas kushteve dhe kritereve të thirrjes publike.

Neni 26

Intervistat publike

1. Intervistat publike organizohen në mënyrë të tillë që t'i japin mundësi të gjithë aplikantëve pjesëmarrës të paraqesin shkurtimisht propozimin e tyre, si dhe zyrtarëve të autorizuar për vlerësimin përmbajtësor që të parashtrojnë pyetjet e veçanta të cilat mund t'i ndihmojnë ata në vlerësimin e aplikimit përkatës.

2. Gjatë intervistave publike, secili aplikant ka kohë të barabartë në dispozicion, përveç rasteve kur intervista publike zhvillohet nëpërmjet përkthimit, me ç'rast aplikantit përkatës i shtohet edhe gjysma e kohës standarde.

3. Intervistat publike organizohen në mënyrë të tillë që të jenë të qasshme për publikun e interesuar, nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë nëpërmjet mjeteve elektronike përkatëse.

4. Ftesa për intervistë publike i dërgohet aplikantit përkatës së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së intervistës, së bashku me vendin dhe orarin e saktë të intervistës publike. Orari i përcaktuar i intervistës publike nuk mund të ndryshohet nga aplikanti, përveç rasteve të jashtëzakonshme që lidhen me shkaqe shëndetësore ose arsye tjera jashtë kontrollit të aplikantit, me ç'rast propozohet një orar tjetër brenda orarit të përgjithshëm të përcaktuar për mbajtjen e intervistave publike për thirrjen përkatëse.

Neni 27

Konfirmimi i vlerësimeve në Këshill dhe publikimi i rezultateve

1. Brenda pesë (5) ditësh pas pranimi të listës së rekomanduar për financim nga komisioni për vlerësim përmbajtësor, anëtarët e Këshillit mund të kërkojnë sqarime për aplikacione të rekomanduara për financim duke i parashtruar pyetje me shkrim komisionit për vlerësim përmbajtësor, të cilët duhet të përgjigjen me shkrim brenda pesë (5) ditësh pas pranimi të pyetjeve.

2. Brenda dhjetë (10) ditësh pas pranimi të listës së rekomanduar për financim, me shumicë votash të të gjithë anëtarëve, Këshilli vendos për aprovimin e listës përfundimtare për financim, duke konfirmuar ose vendosur veton për aplikacionet nga lista e rekomanduar për financim.

3. E drejta e vetos mund të ushtrohet vetëm për ndonjërin nga rastet në vijim:

3.1. Këshilli vlerëson që aplikacioni i rekomanduar për financim është qartë në kundërshtim me interesin publik të Republikës së Kosovës;

3.2. Këshilli vlerëson që aplikacioni i rekomanduar për financim është qartë në kundërshtim me qëllimet dhe objektivat e politikave përkatëse publike;

3.3. Këshilli vlerëson që aplikacioni i rekomanduar për financim është qartë në kundërshtim me qëllimet dhe objektivat e thirrjes publike;

3.4. Këshilli vlerëson që aplikacioni i rekomanduar për financim është mbivlerësuar financiarisht në një apo më shumë linja buxhetore të propozuara.

4. Për të gjitha bazat e përcaktuara me paragrafin 3 të këtij neni, në aktin administrativ me të cilin vendoset përdorimi i vetos nga ana e Këshillit, pasqyrohet arsyetimi përkatës i cili në mënyrë faktike argumenton një ose më shumë nga rrethanat e përcaktuara në paragrafin 3.

5. Në raste të tejkalimit të buxhetit të planifikuar për thirrjen publike, shkurtimeve buxhetore apo rrethanave të veçanta, Këshilli mund:

5.1. Të vendosë për shkurtimin e përgjithshëm të buxheteve totale nga lista e rekomanduar për financim, por jo më shumë se 30% nga buxheti total nga lista e rekomanduar për financim; dhe/apo

5.2. Të vendosë për shkurtimin e listës së përfituesve me numrin më të vogël të pikëve në përputhje me mundësitë buxhetore.

6. Brenda dy (2) ditëve të punës lista e rekomanduar për financim miratohet nga ZKA, dhe përmes sistemit elektronik njoftohen aplikantët për rezultatin e vlerësimit përmbajtësor së bashku me pikët e përgjithshme dhe komentet e anonimizuara të vlerësuesve. Në rastet e vlerësimit negativ, ofrohen informacionet mbi të drejtën dhe kushtet e ankesës. Në rastet e vlerësimit negativ si rezultat i ushtrimit të së drejtës së vetos, apo rrethanave si në paragrafin 5 të këtij neni, arsyetimi përkatës i paraprinë komenteve nga vlerësuesit.

7. Lista e përfituesve nga thirrja publike publikohet në faqet elektronike të Këshillit dhe/apo Ministrisë brenda dy (2) ditësh pas aprovimit të listës përfundimtare për financim, pas shqyrtimit të ankesave.

Neni 28

Afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave në vlerësimin përmbajtësor

1. Brenda dy (2) ditëve të punës nga pranimi i rezultatit të vlerësimit përmbajtësor, aplikanti i cili ka rezultuar me vlerësim negativ ka të drejtë që të parashtrojë ankesë vetëm në rast se argumenton se një ose më shumë prej dëshmive të dorëzuara, nuk janë shqyrtuar fare nga komisioni për vlerësim përmbajtësor.

2. Vlerësimet negative si rezultat i ushtrimit të së drejtës së vetos nga Këshilli, apo rrethanave si në nenin 27, paragrafi 5, nuk janë të ankimeshme.

3. Ankesa ndaj rezultateve të vlerësimit përmbajtësor shqyrtohet nga zyrtarët e autorizuar nga ZKA për shqyrtimin e ankesave brenda pesë (5) ditëve të punës pas kalimit të afatit përfundimtar për dorëzim të ankesave.

4. Zyrtarët e autorizuar për shqyrtim të ankesave nuk kanë mandat për të shqyrtuar ankesat ndaj vlerësimit administrativ, apo vendimeve për vlerësimin e aplikacioneve nga aspekti përmbajtësor, por vetëm në rastet kur ankesa ka të bëjë me mostrajtim të materialeve të dorëzuara nga aplikanti sipas kërkesave të thirrjes për aplikim apo rasteve kur ka vlerësim me zero pikë dhe mungesë të arsyetimit përkatës.

5. Në rast të aprovimit të ankesës nga zyrtarët e autorizuar për shqyrtimin e ankesave, aplikimi rivlerësohet nga zyrtarët e autorizuar për vlerësimin përmbajtësor për thirrjen përkatëse, duke u siguruar që dëshmia/të e pashqyrtuar/a përfshihen në vlerësimin përmbajtësor, në përputhje me dispozitat për vlerësimin përmbajtësor të kësaj rregulloreje.

6. Vendimet e zyrtarëve të autorizuar për shqyrtim të ankesave janë përfundimtare.

Neni 29

Parandalimi i konfliktit të interesit

1. Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, Këshilli duhet të sigurojë që të mos ekzistojë ose të shmanget çfarëdo konflikti i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

2. Anëtarët e emëruar të Komisionit Vlerësues, përkatësisht të Komisionit të Ankesave duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar deklaratën me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt interesi.

3. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet ta deklarojnë të njëjtin dhe të kërkojnë nga Këshilli zëvendësimin e tyre.

4. Anëtari rezervë i komisionit zëvendëson anëtarin i cili tërhiqet për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit.

Neni 30

Format e tjera të financimit të skenës së pavarur kulturore

1. Format e tjera të financimit të skenës së pavarur janë mbështetja për raste emergjente dhe mbështetja për projekte/programme të rëndësishë së veçantë, në përputhje me nenin 13 dhe nenin 14 të kësaj rregulloreje.

2. Aplikimi për mbështetjen si në paragrafin 1 të këtij neni bëhet përmes sistemit elektronik me parashtrimin e kërkesës dhe ofrimit të dëshmime në përputhje me kushtet e përcaktuara në planin vjetor për mbështetje financiare të skenës së pavarur kulturore.

3. Vlerësimi i aplikimit për mbështetje në rastet emergjente bëhet në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në planin vjetor për mbështetje financiare dhe përfshin hapat si vijon:

3.1. Brenda dy (2) ditëve të punës pas aplikimit, Këshilli vlerëson nëse aplikimi i plotëson kushtet e urgjencës të përcaktuara me nenin 13 të kësaj rregulloreje. Nëse vlerësimi është pozitiv, vazhdohet si në nënparagrafin 2 të paragrafit 3 të këtij neni, ndërsa nëse vlerësimi është negativ, aplikanti njoftohet përmes sistemit elektronik për vendimin dhe arsyetimin përkatës;

3.2. Brenda tri (3) ditëve të punës bëhet vlerësimi administrativ nga zyrtarët e autorizuar nga Ministria dhe vlerësimi përmbajtësor nga Këshilli, në përputhje me kushtet e aplikueshme të përcaktuara me nenin 24 dhe 25, përveç në rastet kur është përcaktuar ndryshe nga ky nen;

3.3. Në rast të vlerësimit negativ administrativ, brenda dy (2) ditëve të punës nga pranimi i raportit, aplikanti ka të drejtë që në sistem të ngarkojë një parashtrim të arsyetuar ankimor dhe të plotësojë dëshmitë e munguara apo të dorëzuara në formë të parregullt, me kushtin që të njëjtat janë hartuar/lëshuar para datës së aplikimit;

3.4. Zyrtari/ët përkatës brenda dy (2) ditëve të punës shqyrton/jnë dëshmitë e plotësuara dhe merr/marrin vendimin për vlerësimin administrative;

3.5. Në rast të vlerësimit negativ përmbajtësor, brenda dy (2) ditëve të punës nga pranimi i raportit, aplikanti ka të drejtë që në sistem të ngarkojë një parashtrim ankimor në përputhje me kushtet e përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 28 të kësaj rregulloreje;

3.6. Këshilli brenda dy (2) ditëve shqyrton dëshmitë e ofruara përmes parashtrimit ankimor, dhe merr vendimin për vlerësimin përmbajtësor;

3.7. Në rastin kur zyrtari/ët e autorizuar për vlerësimin administrativ apo Këshilli, me vendim sipas nënparagrafit 4 dhe nënparagrafit 6 të këtij neni, kanë vlerësim negativ për aplikimin, procesi i vlerësimit përfundon dhe aplikanti përmes sistemit elektronik merr njoftimin;

3.8. Në rastin kur vlerësimi administrativ dhe vlerësimi përmbajtësor është pozitiv, Këshilli miraton kërkesën dhe ofron rekomandim për ZKA-në sipas kushteve të përcaktuara me nenin 14, paragrafi 7.

4. Vlerësimi i kërkesës për mbështetje për projekte/programme të rëndësisë së veçantë bëhet nga Këshilli. Varësisht nga rrethanat e projektit/programit të rëndësisë së veçantë, Këshilli harton planin e aktiviteteve dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vlerësimin adekuat dhe rekomandimin për Ministrin sipas kushteve të përcaktuara me nenin 14, paragrafi 5.

5. Pas aprovimit të kërkesës nga ana e Ministrit, si në paragrafin 4 të këtij neni, aplikantit i mundësohet përfshirja e të dhënave të projektit/programit në sistemin elektronik, prej të cilave hartohen kontrata, plani i monitorimit si dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet për raportim dhe zbatim të kontratës.

6. Këshilli, sipas nevojës, mund të autorizoj angazhimin e një (1) apo më shumë ekspertëve të vlerësimit përmbajtësor në kuadër të procesit të vlerësimit përmbajtësor për format e mbështetjes në raste emergjente dhe mbështetjes për projektet/programet e rëndësisë së veçantë, siç është përcaktuar me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 31 **Kontrata me përfituesin**

1. Kontrata me përfituesin e mbështetjes financiare lidhet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e aprovimit përfundimtar për mbështetjen për financim, përveç rasteve të jashtëzakonshme për të cilat Këshilli mund të autorizojë shtyrjen e afatit edhe për tridhjetë (30) ditë shtesë.

2. Gjatë fazës së përgatitjes së kontratës, aplikantët ftohen të ofrojnë:

2.1. Kornizën logjike apo instrument tjetër të ngjashëm të projektit ose programit të aprovuar për mbështetje financiare;

2.2. Buxhetin përfundimtar, përfshirë planin e pagesave të kësteve, kur ka të tilla;

2.3. Planin e aktiviteteve.

3. Kontrata me përfituesin përmban:

- 3.1. Të dhënat e subjektit përfitues dhe përfaqësuesit të autorizuar të subjektit përfitues, qëllimin e mbështetjes financiare, formën dhe modelin e mbështetjes financiare, shumën e financimit, periudhën e zbatimit, si dhe kushte të veçanta për zbatimin e projektit ose programit të mbështetur, nëse ka të tilla;
 - 3.2. Dispozitat standarde dhe të veçanta për monitorimin e zbatimit dhe raportimin për aktivitetin, projektin ose programin e mbështetur, përfshirë afatet e raportimit;
 - 3.3. Dispozita për ndalimin e përdorimit të mjeteve për qëllime tjera përveç qëllimit të veçantë për përkrahje financiare;
 - 3.4. Dispozita me të cilat obligohet përfituesi që mjetet nga mbështetja financiare t'i pranojë në një llogari të veçantë bankare vetëm për mbështetjen përkatëse, si dhe ato mjete t'i shpenzojë përmes transaksioneve bankare në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - 3.5. Plani i pagesave të kësteve, duke përfshirë shumën e paradhënies;
 - 3.6. Dispozita për obligimin e parandalimit të konfliktit të interesit gjatë zbatimit të projektit ose programit të mbështetur;
 - 3.7. Dispozita lidhur me trajtimin e mosmarrëveshjeve;
 - 3.8. Dispozita lidhur me rastet kur mund të shkëputet kontrata;
 - 3.9. Dispozita me të cilat rregullohet kthimi i mjeteve të mbetura në përfundim të kontratës, ose në rast të shkëputjes së kontratës;
 - 3.10. Dispozitat për vizibilitet mbi përdorimin dhe vendosjen e logos apo formave të tjera të identifikimit të Ministrisë në aktivitetet e mbështetura financiarisht.
4. Këshilli shqyrton dhe miraton shabllonin e kontratave për mbështetje financiare për secilën formë të mbështetjes financiare të përgatitur nga Ministria.
 5. Këshilli përcakton kushtet e veçanta të kontratave për mbështetje financiare.
 6. Pjesë obligative e kontratës, si shtojca të veçanta, janë edhe dokumentet që përcaktojnë udhëzimet e përgjithshme për zbatim, menaxhim të buxhetit, raportim dhe monitorim.
 7. Kontrata për mbështetje financiare miratohet nga Kryesuesi i Këshillit, ndërsa nënshkruhet nga ZKA dhe përfaqësuesi i autorizuar i subjektit përfitues.
 8. Një dokument përmbledhës për secilin përfitues të mbështetjes financiare me informatat bazë të projektit ose programit të financiar të përcaktuara në nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të këtij neni publikohet në faqet elektronike të Këshillit dhe Ministrisë jo më vonë se pesë (5) ditë pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin.

Neni 32

Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve

1. Për secilën kontratë të lidhur, Ministria cakton një zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të projektit.
2. Përfituesi raporton te zyrtari përgjegjës në përputhje me kërkesat dhe afatet kontraktuale, por të paktën sipas kërkesave minimale në vijim:
 - 2.1. për projektet ose programet që nuk e tejkalojnë periudhën një (1) vjeçare të zbatimit, të paktën një raport të ndërmjetëm, narrativ dhe financiar, si dhe një (1) vizitë monitoruese;
 - 2.2. për projektet ose programet me kohëzgjatje të mbështetjes financiare më shumë se një (1) vit, të paktën një (1) raport për secilin vit të zbatimit, narrativ dhe financiar, si dhe një vizitë monitoruese për secilin vit të zbatimit;
 - 2.3. për të gjitha kontratat e mbështetjes financiare, një (1) raport përfundimtar pas përfundimit të periudhës së zbatimit, narrativ dhe financiar.
3. Me qëllim të plotësimit të qëllimeve të thirrjes publike, vendimeve për mbështetje financiare, si dhe udhëzimeve për monitorim dhe raportim, zyrtari përgjegjës dhe anëtarët e Këshillit mund të komentojnë dhe parashtrojnë kërkesa për sqarime ose përmirësime të raporteve të listuara në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Vizitat monitoruese nga zyrtari përgjegjës duhet të përfshijnë aspekte të zbatimit përmbajtësor dhe financiar të projektit ose programit përkatës, përfshirë nivelin aktual të rezultateve të arritura ose që janë në proces, rregullsinë e shpenzimit të mjeteve financiare, sfidat e hasura gjatë zbatimit dhe ndikimin e përgjithshëm të arritur ose të pritur të projektit ose programit të mbështetur.
5. Në vizita monitoruese mund të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit.
6. Brenda pesë (5) ditëve pas vizitës monitoruese, zyrtari përgjegjës përfundon raportin e vizitës monitoruese, i cili, ndër të tjera, shërben edhe si burim zyrtar i informacionit për vlerësim, komentim dhe aprovim të raporteve narrative dhe financiare.
7. Arovimi i raporteve narrative dhe financiare të listuara në paragrafin 2 të këtij neni është kusht për ekzekutimin e pagesës së radhës, në përputhje me planin e pagesave të përcaktuar në kontratë.
8. Përveç raporteve kontraktuale të listuara në paragrafin 2 të këtij neni, secili përfitues i mbështetjes financiare, në baza mujore plotëson formularin elektronik të statistikave themelore të zbatimit të projektit ose programit përkatës, për nevoja të sistemit të përgjithshëm të monitorimit të mbështetjes financiare.
9. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesi, zyrtari përgjegjës raporton ZKA-së dhe njofton Këshillin duke rekomanduar për hapat e mëtejme. Masat e propozuara duhet të jenë proporcionale me shkeljen e bërë nga përfituesi.

10. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës, në përputhje me dispozitat e kontratës përkatëse, dhe me miratim të Këshillit, ZKA mund të nxjerrë vendim për ndërprerjen e kontratës, përfshirë iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 33 **Mbyllja e kontratës**

1. Për secilën kontratë të lidhur, pas përfundimit të afatit të zbatimit, zyrtari përgjegjës për monitorimin e zbatimit të projektit ndërmerr procedurat për mbylljen e kontratës, të cilat përfshijnë:

1.1. pranimin e raportit përfundimtar narrativ dhe financiar nga përfituesi i mbështetjes financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike;

1.2. përcjelljen e komenteve nga zyrtari përgjegjës dhe/ose Këshilli, si dhe sigurimin që të njëjtat janë adresuar nga përfituesi i mbështetjes financiare;

1.3. aprovimin e raporteve përfundimtare narrative dhe financiare, pas adresimit të komenteve;

1.4. për të gjitha kontratat e mbështetjes financiare me shuma më të larta se dhjetë mijë (10,000) euro, pranimin e raporteve të auditimit të jashtëm financiar të OJQ-së apo projektit individual dhe konstatimin e listës së gjetjeve të auditorit, të cilat duhet të trajtohen para aplikimit të radhës për fonde publike;

1.5. bazuar në raportet financiare të aprovuara dhe raportet e auditimit të jashtëm financiar, përcaktimin e shpenzimeve totale të mbështetjes financiare dhe shumës së mbetur;

1.6. komunikimin me përfituesin e mbështetjes financiare për kthimin e shumës së mbetur;

1.7. komunikimin me përfituesin e mbështetjes financiare për përmbushjen e çfarëdo dispozite të veçantë të kontratës për mbështetje financiare që lidhet me përmbylljen e kontratës.

2. Pas plotësimit të të gjitha kushteve të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, zyrtari përgjegjës mbyll zyrtarisht kontratën e mbështetjes financiare dhe i ofron përfituesit dëshminë përkatëse të mbylljes.

Neni 34 **Kontratat paralele**

1. Subjekti i pavarur i kulturës i cili ka kontratë të hapur me ofruesin e mbështetjes financiare në fushën e kulturës nuk kufizohet nga mbështetja në thirrje të hapura, përveç rasteve në vijim:

1.1. kur nuk ka arritur që ta mbyllë kontratën paraprake përkundër tejkalimit të afatit të mbylljes dhe afateve shtesë eventuale;

1.2. kur kontrata paraprake është ndërprerë për shkak të shkeljeve të rënda dhe nga dita e ndërprerjes së kontratës nuk kanë kaluar më pak se tre (3) vjet;

1.3. kur është në proces gjyqësor për shkak të padisë nga ofruesi i mbështetjes financiare.

2. Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Këshilli mund të vendosë kufizime të aplikimit në forma të veçanta për përfituesit aktivë të formave tjera.

Neni 35

Angazhimi dhe kompensimi i ekspertëve të vlerësimit përmbajtësor

1. Ekspertët e vlerësimit përmbajtësor duhet të jenë individ të dëshmuar apo të kenë njohuri rreth fushës së kulturës, artit dhe trashëgimisë kulturore.

2. Këshilli, me mbështetjen e njësive përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të Ministrisë, rekruton ekspertët e vlerësimit përmbajtësor përmes thirrjes publike. Thirrja publike hartohet nga Këshilli dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.

3. Thirrja publike sipas nënparagrafit 2 të këtij neni duhet të përmbajë, por nuk kufizohet në:

3.1. Qëllimin e angazhimit;

3.2. Kushtet e angazhimit;

3.3. Periudhën e angazhimit;

3.4. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit;

3.5. Kriteret e kualifikimit për ekspertin;

3.6. Dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;

3.7. Kompensimin dhe apo metodologjinë e kompensimit;

3.8. Forma e dorëzimit të aplikimit.

4. Këshilli është i obliguar të përcaktoj planin e rekrutimit të ekspertëve të vlerësimit përmbajtësor në kuadër të planit vjetor që rregullohet me nenin 18 të kësaj rregulloreje. Në kuadër të këtij plani Këshilli duhet të përcaktoj numrin e ekspertëve që duhet të angazhohen dhe periudhën e angazhimit e cila mund të jetë deri në tri (3) vite.

5. Këshilli është i obliguar të bëjë vlerësimin e performancës të ekspertëve të vlerësimit përmbajtësor pas çdo thirrje publike për mbështetjen financiare apo ndonjë forme tjetër të mbështetjes sa i përket shkallës së efikasitetit dhe efektivitetit.

6. Ekspertit për vlerësimin përmbajtësor duhet t'i shkëputet kontrata në rrethanat si në vijim:

6.1. Në rast se vlerësimi i performancës nga Këshilli është nën 60% nga 100% të shkallës së arritshmërisë më shumë se dy herë;

6.2. Nëse vërtetohet ekzistimi i vazhdueshëm i situatës së konfliktit të interesit;

6.3. Nëse vërtetohet nga Këshilli se në rastin konkret një apo më shumë ekspertë qartazi kanë dështuar të reflektojnë etikën e shërbimit publik apo kanë cenuar integritetin profesional të manifestuar në vlerësimet përkatëse;

6.4. Nëse i njëjti refuzon kërkesën për angazhim në vlerësimin përmbajtësor të thirrjes përkatëse më shumë se dy herë rradhazi sipas kushteve të përcaktuara në nenin 36 të kësaj rregulloreje;

6.5. Rrethana të tjera që mund të përcaktohen me kushtet e veçanta të kontratës dhe/apo në legjislacionin në fuqi.

7. Kompensimi i ekspertëve bëhet për ditë pune. Numri i ditëve të punës për të cilat kompensohet eksperti në kuadër të një thirrjeje publike për mbështetje financiare përcaktohet nga mesatarja e ditëve të punës të të gjithë ekspertëve të angazhuar në atë thirrje. Në rastet kur një ekspert zëvendësohet nga një ekspert tjetër, kompensimi përcaktohet në mënyrë proporcionale me numrin e ditëve të punës.

8. Kompensimi i ekspertëve për ditë pune është në vlerën e barazvlefshme me vlerën e koeficientit të pagës mesatare në shërbimin publik të përcaktuar me ligjin mbi ndarjen buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin përkatës.

9. Ekspertët e vlerësimit përmbajtësor nuk mund të jenë të emëruarit politik dhe shërbyesit civil të punësuar në administratën qendrore të Ministrisë apo të punësuarit tjerë nëpër institucione vartëse të Ministrisë.

Neni 36 **Komisioni për vlerësim përmbajtësor**

1. Për çdo thirrje publike të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore përcaktohen tre (3) ekspertë për vlerësimin përmbajtësor dhe një (1) ekspert rezervë nga lista e ekspertëve të angazhuar sipas nenit 35 të kësaj rregulloreje. Komisioni për vlerësim përmbajtësor duhet të aprovohet nga Këshilli. Në rastet kur thirrjet publike qëndrojnë të hapura gjatë gjithë periudhës kohore prej aprovimit të planit vjetor, ekspertët për vlerësimin përmbajtësor autorizohen për vlerësim të aplikimeve të thirrjes publike deri në fund të vitit përkatës fiskal.

2. Përzgjedhja e anëtarëve të komisionit për vlerësim përmbajtësor bëhet përmes sistemit kompjuterik në mënyrë algoritmike duke u siguruar që:

2.1. I njëjti ekspert për vlerësimin përmbajtësor të mos përfshihet në komision në tre thirrje të njëpasnjëshme;

2.2. Komisioni për vlerësim përmbajtësor të mos ketë përfaqësim vetëm nga njëra gjini.

3. Komisioni për vlerësim përmbajtësor duhet të aprovohet së paku dy (2) ditë pune para mbylljes së thirrjes përkatëse publike për mbështetje financiare.
4. Çdo anëtar i komisionit për vlerësim përmbajtësor, brenda dy (2) ditë kalendarike pas aprovimit nga Këshilli duhet të nënshkruaj deklaratën mbi paanshmërinë, konfliktin e interesit dhe konfidencialitetin në vendimarrje.
5. Këshilli harton rregullat e detajuara të punës së komisionit për vlerësim përmbajtësor.

KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 37 Dispozitat kalimtare

1. Të gjitha thirrjet publike që shpallen deri fillimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, administrohen duke zbatuar kornizën paraprake juridike.
2. Pavarësisht afateve dhe rrethanave objektive, kjo rregullore zbatohet pas emërimit të të gjithë mekanizmave që parashikohen në këtë akt normativ dhe zhvillimit të të gjitha mjeteve, sistemeve dhe manualeve elektronike.

Neni 38 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen, përkatësisht shpallen të pazbatueshme të gjitha dispozitat e akteve nënligjore në fuqi të cilat rregullojnë financimin publik në fushën e kulturës.

Neni 39 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

31/10/2025